



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës
01 Nr. _____/2024
Datë: 30.01.2024

Kuvendi i Komunës së Gjakovës duke u bazuar në nenin 11, nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja d, dhe nenin 17 paragrafi 1 shkronja b, të Ligjit Nr. 03/L- 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës Së Kosovës, Nr.28, datë: 04. Qershor 2008"), në bazë të nenin 5, paragrafi 1.2, pika 1.2.2 dhe nenin 6 paragrafi 1.2 pika 1.2.1 , nenin 10, paragrafi 2, pika 2.2, nenin 11 dhe nenin 16, të Ligjit Nr-04/L-174 për Planifikimin Hapësinor "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 30/2013", nenin 15 paragrafi 1 pika b të Statutit të Komunës së Gjakovës me numër 01 Nr.110/04-29365 datë 30.12.2022, Udhëzimit Administrativ të MMPH nr. 24/2015 Mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, Vendimit për Hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Gjakovës 01nr.011/01-13310/2019 datë 28.03.2019, Planit Zhvillimor Komunal Vendimi numër 01 Nr.01/101-11250 datë 05.05.2022 si dhe vendimit për pëlqim Mjedisor të MMPH-së për raportin e vlerësimit strategjik mjedisor për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës Nr. 4607-2/21 të datës 11.10.2022, dhe Vendimit të MMPHI-së me Nr. 4976-2/23 të datës 16.01.2024 për dhënien e pëlqimit për miratim të Hartës Zonale të Komunës së Gjakovës 2024-2032, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.01.2024 pas diktimeve lidhur me pikën e 4 të rendit të ditës : Kërkesë për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Gjakovës 2024-2032 e miratoi këtë:

V E N D I M

Për

miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Gjakovës 2024-2032

1. MIRATOHET Harta Zonale e Komunës së Gjakovës, për periudhën tetë (8) vjeçare 2024-2032 , si një dokument multi-sektorial që përmes grafi koneve, fotografive, hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe projeksioneve të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Komunës së Gjakovës.
2. Me Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës, përcaktohen kushtet zhvillimore dhe kushtet ndërtimore për zonat urbane dhe rurale në kontekst të ndryshimeve të bëra me nevojat reale dhe mundësi për të arritur kushtet optimale të rregullimit dhe ndërtimit në Komunën e Gjakovës.

3. Me miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Gjakovës shfuqizohen të gjitha Planet Rregulluese Urbane dhe Planet tjera të Komunës së Gjakovës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në koordinim dhe bashkëpunim me Drejtoritë sektoriale brenda Komunës së Gjakovës.
5. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës së Gjakovës.

Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Gjakovës.
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.
- Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës.
- Arkivit.



Arbëneshaj Kuqi

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës